



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

**RAPORT MBI STATUSIN E
VËSHTIRËSIVE FINANCIARE
TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE
VITI 2020**

Përmbajtja

Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore	3
I. Hyrje.....	3
II. Metodologjia dhe Mbledhja e të Dhënave	8
III. Analiza mbi Treguesit e Përgjithshëm të Detyrimeve të Prapambetura të Bashkive.....	8
V. Analiza e Detajuar mbi Treguesit e Detyrimeve të Prapambetura për Secilën Bashki	22
Bashkia Belsh.....	22
Bashkia Berat.....	23
Bashkia Bulqizë.....	25
Bashkia Cërrik.....	27
Bashkia Delvinë	29
Bashkia Devoll	31
Bashkia Dibër.....	32
Bashkia Dimal	33
Bashkia Divjakë.....	35
Bashkia Dropull	37
Bashkia Durrës.....	38
Bashkia Elbasan	39
Bashkia Fier	41
Bashkia Finiq.....	42
Bashkia Fushë Arrëz	43
Bashkia Gjirokastër.....	45
Bashkia Gramsh.....	47
Bashkia Has	49
Bashkia Himarë.....	51
Bashkia Kamëz.....	52
Bashkia Kavajë.....	54
Bashkia Këlcyrë.....	55
Bashkia Klos.....	57
Bashkia Kolonjë	59
Bashkia Korçë	60
Bashkia Krujë.....	62
Bashkia Kuçovë.....	64
Bashkia Kukës	66
Bashkia Kurbini.....	68
Bashkia Lezhë	70
Bashkia Libohovë.....	72
Bashkia Librazhd.....	74

Bashkia Lushnjë.....	76
Bashkia Malësi e Madhe.....	78
Bashkia Maliq	80
Bashkia Mallakastër	82
Bashkia Mat.....	84
Bashkia Memaliaj	86
Bashkia Mirditë	88
Bashkia Patos	90
Bashkia Peqin	91
Bashkia Përmet	93
Bashkia Pogradec	95
Bashkia Poliçan.....	97
Bashkia Prrenjas	99
Bashkia Pukë	101
Bashkia Roskovec	103
Bashkia Sarandë	105
Bashkia Selenicë	107
Bashkia Shijak.....	109
Bashkia Skrapar	110
Bashkia Shkodër	112
Bashkia Tepelenë	114
Bashkia Tiranë	116
Bashkia Tropojë.....	118
Bashkia Vau i Dejës.....	120
Bashkia Vlorë.....	122
Bashkia Vorë.....	124
VI. Konkluzione.....	126

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
 të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
 Confédération suisse
 Confederazione Svizzera
 Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore

Raporti i konsoliduar është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e ekipit e projektit “Financat Lokale”¹, mbi bazën e të dhënave të raportuara nga bashkitë e vendit dhe në funksion të qëllimit zbatimit të udhëzimit nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore” (neni 2/i) për implementimin e një sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftësi paguese. Të dhënat pasqyrojnë detyrimet për 58 bashki, ku mungojnë bashkitë e Konispolit, Pustecit dhe Rrogozhinës.

Viti 2020 duhet të konsiderohet një vit i veçantë dhe i jashtëzakonshëm, duke pasur parasysh dëmtimin që shkaktoi tërmeti i fundvitit 2019 dhe situata pandemike COVID 19 mbi proceset e menaxhimit të financave vendore në Shqipëri. Si i tillë viti 2020 nuk rekomandohet të merret si bazë krahasimi kur trajtohen trendet e performancës financiare të NJVQV-ve në vite. Në kushtet e burimeve të limituara financiare, bashkitë u detyruan të shkurtojnë shpenzimet vendore të rialokonin fondet duke u përpjekur nga njëra anë të mbajnë vetëm shërbimet jetike për komunitetin dhe, nga ana tjetër, të mbajnë nën kontroll riskun e krijimit/rritjes së detyrimeve të prapambetura. Këto emergjenca të papritura dhe me mjaft ndikim rezultuan në "progres të ngecur" për shumë bashki (dhe regresion, për disa). Megjithatë kjo përvojë ka ndihmuar bashkitë duke rritur ndërgjegjësimin dhe kapacitetin për t'iu përgjigjur krizës aktuale, por edhe për t'u përgatitur për kriza të ardhshme.

Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të dhjetorit 2020 për njësitë e qeverisjes vendore (sipas Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë) është 7 miliardë lekë (6,895,013,355 lekë), i cili përbën 49% të totalit të detyrimeve financiare të qeverisjes së përgjithshme (14,064,627,507.98 lekë²). Sic mund të shihet kjo është një shifër e konsiderueshme që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në situatën fiskale të qeverisjes së përgjithshme. Që këtej rrjedh: (i) rëndësia që menaxhimi i lartë i bashkive duhet t'i kushtojë menaxhimit të borxhit të prapambetuar dhe kujdesit në marrjen përsipër të angazhimeve të reja, si dhe (ii) domosdoshmëria e monitorimit të ngushtë deri në kontroll direkt të angazhimeve publike që duhet të ushtrojë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkitë që rezultojnë me vështirësi financiare deri në paaftësi paguese.

Statusi i Bashkive në fund të vitit 2020 (vetëvlerësimi i bashkive)

Nr. i Bashkive	% e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve vjetore të miratuara 2020	Situata Financiare e fundvitit 2020
37 Bashki	Nga 0 deri 15 %	Pa probleme financiare
11 Bashki	Nga 16% deri 25%	Me probleme financiare
10 Bashki	Nga 26% deri 70%	Në vështirësi financiare

¹ Projekti “Financat Lokale” financohet nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

² Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Detyrimet-e-Prapambetura-Dhjetor-2020-sipas-institucioneve-perfundimtare”

Vlerësime dhe Problematika

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson performancën financiare të 37 bashkive të vendit që kanë mundur të mbajnë në nivel të ulët stokun e detyrimeve të prapambetura, pavarësisht vështirësive financiare të vitit 2020. Vlen të përmendim në mënyrë të veçantë bashkitë Shkodër, Dropull dhe Patos që figurojnë me 0% detyrime financiare të prapambetura dhe 18 bashkitë: Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Gjirokastrë, Maliq, Shijak, Gramsh, Mallakastër, Vau i Dejës, Prrenjas, Kolonjë, Fushë-Arrëz, Mat, Përmet, Bulqizë, Krujë, Libohovë që figurojnë me 1 deri 6 % të detyrimeve financiare të prapambetura ndaj shpenzimeve të miratuara.

Pavarësisht krizës pandemike, ka një reduktim në vlerë absolute të totalit të detyrimeve financiare të prapambetura në nivel vendor në krahasim me 2019. 38 bashki kanë reduktuar stokun e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2020. Bashkia e Kavajës me vështirësi serioze financiare, apo bashkitë me vështirësi financiare si Dimal, Kukës kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për përmirësim të statusit të vështirësisë financiare gjatë 2020 (kjo referuar shpenzimeve vjetore të miratuara). Nisur nga kriteri i udhëzimit të MFE që llogarit nivelin e situatës financiare në referencë me shpenzimet vjetore të planifikuara, Bashkia e Vorës ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 75% të shpenzimeve të miratuara dhe Bashkia e Kavajës në nivelin e 70% të shpenzimeve të miratuara duke shënuar një status me vështirësi financiare. Dhjetë bashki kanë vështirësi financiare (Roskovec, Lezhë, Tepelenë, Këlcyrë, Belsh, Pogradec, Kuçovë, Poliçan, Kavajë, Vorë), 11 bashki (Kamëz, Divjakë, Klos, Cërrik, Selenicë, Finiq, Tropojë, Delvinë, Kukës, Dimal e Dibër) kanë probleme financiare, ndërsa 37 bashki të tjera kanë situatë financiare të normalizuar. Vihet re se bashkitë që demonstrojnë probleme financiare apo janë në vështirësi financiare janë më së shumti bashkitë me shpenzime të planifikuara për frymë për vitin 2020 nën mesataren prej 20,130 lekë për banorë.

Ndërkohë, 20 bashki kanë pësuar rritje të stokut të detyrimeve gjatë vitit 2020. Situata financiare është përkeqësuar për bashkitë e Lezhës dhe e Roskovecit duke u klasifikuar si bashki në vështirësi financiare në fund të vitit 2020, ndërsa bashkia e Divjakës klasifikohet për herë të parë si një bashki me probleme financiare.

Vecanërisht, statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë për 5 bashki, nga bashki pa probleme financiare në bashki me probleme financiare (Delvina) dhe në vështirësi financiare (Kuçovë, Belsh, Këlcyrë). Vecanërisht, Bashkia e Vorës, nga një bashki pa probleme financiare në 2019, klasifikohet si një bashki në vështirësi financiare në 2020 me një tregues 75%, shumë pranë statusit të vështirësisë serioze financiare.

Në 21 bashkitë me probleme apo vështirësi financiare, 25.89% e detyrimeve janë të natyrës së shpenzimeve korrente, 61.73% të natyrës së shpenzimeve kapitale, 11.78% të natyrës nga vendimet gjyqësore dhe 0.82% hua afatgjatë. Në dallim nga viti 2019, vihet re një reduktim i detyrimeve të natyrës së shpenzimeve korrente dhe një rritje të detyrimeve shpenzime kapitale.

Të gjitha bashkitë me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve të miratuara kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale. Bëjnë përjashtim:

- a. Bashkia e Kavajës, Tepelenës dhe Finiqit, ku pjesa më e madhe e detyrimeve është e natyrës së shpenzimeve korrente, respektivisht 72.67%, 70.43% dhe 55.32%.
- b. Bashkia e Pogradecit, Dibër dhe e Lezhës, ku pjesa më e madhe e detyrimeve është e natyrës së vendimeve gjyqësore, respektivisht 65.27%, 57.03% dhe 38.09%.

Ndërkohë që Lezha është e vetmja bashki me detyrime të natyrës së huasë afatgjatë me 9.08% të totalit të detyrimeve të saj.

Raporti i detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit 2020 është përkeqësuar për një numër të konsiderueshëm bashkish. Situata në bashkinë e Vorës është shumë më serioze ku detyrimet e prapambetura shënojnë 204% të shpenzimeve faktike në vitin 2020, pasi buxheti për vitin 2020 është realizuar vetëm në masën 36.6%. Po kështu treguesi detyrimeve të prapambetura përkeqësohet për bashkinë e Kavajës me tregues mbi 100% dhe për bashkinë e Roskovecit, Poliçanit me tregues mbi 50%.

Në kushtet kur mesatarisht buxheti nga bashkitë realizohet në masën prej 73.53% dhe 28 bashki kanë një tregues të realizimit të buxhetit nën mesatare, krijimi i angazhimeve të reja financiare duhet të vlerësohet me kujdes nga bashkitë.

Konkluzione

Ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të përcaktojë qendrimin e saj sipas përgjegjësive që i jep ligji, të miratojë politika mbështetëse për secilën nga bashkitë me probleme financiare, apo të parashtrojë rekomandime të dedikuara lidhur me mundësinë e uljes së nivelit të detyrimeve të prapambetura nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit financiar, vetëm nëse bashkitë dërgojnë raporte të plota (jo vetëm tabelare apo të pjesshme) me analizë të thelluar të riskut mbi:

- a) shkaqet që cojnë në akumulimin e detyrimeve financiare të prapambetura për bashkinë.
- b) reagimin/vendimet e menaxhimit të lartë (Kryetari, Keshilli Bashkiak), gjatë periudhës së raportimit, për parandalimin apo trajtimin e riskut të krijimit/shtimit të detyrimeve të prapambetura me qëllim mos rëndimin e situatës financiare të bashkisë.
- c) vështirësitë që ka hasur bashkia për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura.
- d) masat e mëtejshme të planifikuara për menaxhimin e riskut në të ardhmen, emërtuar në udhëzim si plani i shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura. Theksojmë që nuk përfshihet thjesht shlyerja e detyrimeve në vlerë cdo vit, por edhe masat përkatëse që cojnë në vlerën e përlogaritur për shlyerje.

Për sa më lart rekomandohet që:

- **krijimi i angazhimeve të reja financiare duhet të vlerësohet me kujdes nga bashkitë**, në kushtet kur mesatarisht buxheti nga bashkitë realizohet në masën prej 73.53% dhe 28 bashki kanë një tregues të realizimit të buxhetit nën mesatare;
- **të gjitha bashkitë e vendit të miratojnë deri në fund të vitit 2021 planin e detajuar të menaxhimit të riskut të krijimit/shtimit të detyrimeve të prapambetura dhe të raportojnë mbi bazën e këtij plani sipas kërkesave të listuara më sipër.** Strukturat e Finances dhe/ose të Auditimit të Brendshëm të bashkive të kryejnë dhe njëherë vlerësimin/verifikimin e detyrimeve financiare të prapambetura në kontabilitet mbi bazën e kritereve të njohjes së borxhit sipas Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”;
- **Ministria e Financave rekomandon të vazhdojnë të mbajnë nën kontroll riskun e krijimit/shtimit të detyrimeve financiare të prapambetura, vecanësisht për 37 bashkitë e vendit të listuara në grafikun nr. 1 të këtij raporti me një nivel të detyrimeve financiare të prapambetura deri në 15% të shpenzimeve të miratuara vjetore,**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë periudhës në vijim do t'i kushtojë një vëmendje të vecantë:

1. përqindjes që zë stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore faktike të secilës bashki, e cila tregon shifrën reale të vështirësisë financiare, sidomos në rastet e diferencave të konsiderueshme midis buxhetit fillestar dhe buxhetit të rishikuar vjetor të bashkive të vendit;
2. ecurisë së shlyerjes së borxhit financiar të prapambetur nga njëra periudhë financiare në tjetrën, i cili tregon nivelin e reagimit të menaxhimit të lartë ndaj riskut dhe përmirësimin e menaxhimit financiar të bashkisë. Monitorimi do të jetë gjashtëmujor për 10 bashkitë me vështirësi financiare dhe një vjekar për 11 bashkitë me probleme financiare, të paraqitura sipas grafikut nr. 1 të këtij raporti.
3. kryerjes së një investigimi më të thelluar dhe monitorim i vazhdueshëm në bashkitë Vorë dhe Kavajë, të cilat kanë një përkeqësim të theksuar të situatës financiare.
4. shqyrtimit të mundësisë së mbështetjes në plan afatgjatë për bashkitë Dibër dhe Pogradec ku pjesa më e madhe e detyrimeve është e natyrës së vendimeve gjyqësore, respektivisht 57.03% dhe 65.27%.

Me qëllim e parashtrimin e rekomandimeve për një ulje të detyrimeve të prapambetura dhe për menaxhim më të mirë financiar, lind e domosdoshme zhvillimi i një dialogu me bashkitë dhe/ose ofrimi i asistencës që në vijim të mblidhet informacion përshkrimor dhe të identifikohen:

- vështirësitë që ata hasin për shlyerjen e detyrimeve;
- shkaqet që cojnë në akumulimin e detyrimeve të reja;
- vështirësitë që bashkitë hasin për hartimin e raporteve të monitorimit të detyrimeve të prapambetura.

I. Hyrje

Në mbështetje të neneve 57 dhe 59 të ligjit nr. 68, datë 17.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ministri i Financave dhe Ekonomisë lëshoi Udhëzimin nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”. Sipas ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në tabelën nr. 1 pasqyrohen katër nivelet e ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

TABELA NR. 1 RASTET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE ME VËSHHIRËSI FINANCIARE

Nr	Rastet	Kriteret e Klasifikimit
1	Probleme financiare (Neni 55)	(i) Detyrimet financiare të konstatuara dhe papaguara të NJVQV- së, ndaj palëve të treta përbëjnë 15 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara, në një muaj të caktuar; (ii) Detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara të NJVQV- së, ndaj palëve të treta tejkalojnë 20 përqind të shpenzimeve vjetore të miratuara në muajn pasues.
2	Vështirësia financiare (Neni 56)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit kur tejkalon nivelin prej 20 përqind, dhe vlera e stokut rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
3	Vështirësia serioze financiare (Neni 57)	Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare, kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
4	Papaftësia paguese (Neni 59)	Kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe / ose shuma e borxheve afatgjata të NJVQV-së dhe detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta është më e lartë se 130 për qind e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Ky raport përgatitet në funksion të qëllimit të udhëzimit (neni 2/i) për implementimin e nje sistemi monitorimi për të identifikuar njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përballen me probleme financiare, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare apo paaftesi paguese.

II. Metodologjia dhe Mbledhja e të Dhënave

Për hartimin e këtij raporti, Drejtoria e Financave Vendore ka mbledhur informacion nga Bashkitë sipas formës tabelare në Aneksin 1 dhe Aneksin 5 të Udhëzimit nr. 27, datë 27.9.2019 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”.

Analizat në seksionin 4 për secilën bashki janë të bazuara në informacionin e dorëzuar nga bashkitë në shkurt 2020 për stokun e detyrimeve të prapambetura deri në Dhjetor 2020. Informacioni tabelor mundëson kryerjen e disa analizave analitike mbi strukturën e detyrimeve dhe planin e shlyerjes së stokut në tre vitet në vijim. Vlen të theksohet se informacioni nuk është dorëzuar nga tre bashki: Bashkia e Konispolit, Bashkia e Pustecit dhe Bashkia e Rogozhinës.

Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore me mbështetjen e projektit të financuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri, SECO për “Financat Lokale”.

III. Analiza mbi Treguesit e Përgjithshëm të Detyrimeve të Prapambetura të Bashkive

Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në dhjetor 2020 për njësitë e vetëqeverisjes vendore-bashki (sipas Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë) është rreth 7 miliardë lekë (6,895,013,355 lekë), prej 10.03% e totalit të shpenzimeve të miratuara nga secila bashki. Të dhënat pasqyrojnë detyrimet për 58 bashki, ku mungojnë bashkitë e Konispolit, Pustecit dhe Rogozhinës. Në krahasim me 2019, kemi një reduktim në vlerë absolute dhe një rënie të mesatares së treguesit të detyrimeve në përqindje të shpenzimeve të planifikuara për secilën bashki, nga 16% në 14.54% në vitin 2019.

Bashkia e Vorës ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin e 74.76% të shpenzimeve të miratuara, dhe Bashkia e Kavajës në nivelin e 69.74% të shpenzimeve të miratuara duke shënuar një status si njësi me vështirësi financiare bashkë me tetë bashki të tjera me përqindje nga 25%-47% (Tabela nr. 2). Njëmbëdhjetë bashki kanë probleme financiare, ndërsa të 37 njësitë e tjera nuk kanë probleme financiare. Përmendim veçanërisht një performancë të mirë të Bashkive të Shkodrës, Fierit, Elbasanit, Durrësit e Tiranës me stok njëshifror të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të miratuara.

TABELA NR. 2 STATUSI I VËSHTRËSISË FINANCIARE PËR BASHKITË 2020 (VETËVLERËSIMI I BASHKIVE)


Nr.	Bashkia	Detyrime të prapambetura (lekë)	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020 (lekë)	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	Statusi i Vështirësisë
37	Të gjitha Bashkitë e Tjera			Nën 15%	Pa probleme
	Kamëz (KMZ)	265,387,540		16.06%	Probleme Financiare
	Divjakë (DVJ)	113,006,060		16.75%	
	Klos (KLS)	58,368,919		16.82%	
11	Cërrik (CRRK)	75,571,176		17.52%	
	Selenicë (SLN)	98,988,441		18.51%	
	Finiq (FNQ)	60,362,510		22.13%	
	Tropojë (TRP)	75,620,737		22.40%	

	Delvinë (DLV)	51,791,304	22.53%	
	Kukës (KKS)	173,016,097	23.11%	
	Dimal (DML)	124,121,418	23.56%	
	Dibër (DBR)	189,482,772	24.88%	
10	Roskovec (RSK)	282,705,197	25.29%	Vështirësi Financiare
	Lezhë (LZH)	336,912,018	26.16%	
	Tepelenë (TPL)	58,056,725	27.99%	
	Këlcyrë (KLC)	44,218,688	28.84%	
	Belsh (BLSH)	97,720,122	29.68%	
	Pogradec (PGR)	387,090,301	31.42%	
	Kuçovë (KCV)	165,144,481	32.32%	
	Poliçan (PLC)	102,281,203	47.10%	
	Kavajë (KVJ)	767,704,732	69.74%	
	Vorë (VR)	702,600,000	74.76%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr.1 pasqyron stokun e detyrimeve të prapambetura për të gjitha bashkitë. Mesatarja e detyrimeve mes bashkive është 14.54%.

GRAFIKU NR. 1 DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHJETOR 2020 NË PËRQINDJE TË SHPENZIMEVE TË MIRATUARA 2020




Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr. 2 pasqyron pozicionimin e bashkive sipas përqindje së detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve të miratuara 2020 përkundrejt shpenzimeve të miratuara për frymë të vitit 2020. Për

përlllogaritjen e shpenzimeve të miratuara për frymë, për treguesin e popullsisë është marrë vlerësimi i përlllogaritur nga Ministria e Financave në bazë të të dhënave të rregjistrimit civil nga Gjendja Civile dhe të dhënat e Censurit 2011. Ky tregues popullsie është përdorur edhe në përlllogaritjen e transfertës së pakushtëzuar për buxhetin 2020. Shpenzimet e miratuara për frymë variojnë nga 7,950 lekë për banor në Bashkinë e Dimalit në 45,700 lekë për banor në Bashkinë e Himarës dhe mesatarja mes 58 bashkive është 20,130 lekë për banor.

Nga grafiku del qartë se pjesa më e madhe bashkive me probleme të vështirësi financiare gjenden në mesataren e shpenzimeve të miratuara për banorë.

GRAFIKU NR. 2 SHPENZIMET E MIRATUARA PËR FRYMË 2020 VS PËRQINDJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NDAJ SHPENZIMEVE TË MIRATUARA



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Krahasuar me statusin e detyrimeve në vitin 2019, tetë bashki rezultojnë të kenë reduktuar stokun më shumë se me 10% (Tabela nr.3). Bashkia e Kavajës me vështirësi serioze financiare, apo bashkitë me vështirësi financiare si Dimal, Kukës kanë përmirësuar statusin e vështirësisë financiare në 2020. Pesë bashki të tjera kanë përmirësuar statusin e tyre përmes një reduktimi të stokut me më shumë se 5%. Bashkia e Mirditës ka përmirësuar statusin nga bashki me probleme financiare në bashki pa problem financiare.

TABELA NR. 3 REDUKTIMI I STOKUT ME MË SHUMË SE 5% PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, 2019-2020

Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i Ndryshimit
Dimal (DML)	23.56%	45.82%	Reduktim >10%; 8 bashki
Kukës (KKS)	23.11%	44.13%	
Bulqizë (BLQ)	5.14%	23.49%	
Libohovë (LBH)	6.44%	23.30%	
Kavajë (KVJ)	69.74%	85.20%	
Librazhd (LBR)	7.01%	21.12%	
Dibër (DBR)	24.88%	37.04%	
Finiq (FNQ)	22.13%	32.79%	
Maliq (MLQ)	1.38%	9.02%	Reduktim 5-10%; 5 bashki
Gjirokastër (GJRK)	0.50%	6.89%	
Mirditë (MRD)	13.18%	19.25%	
Shijak (SHJK)	1.52%	7.27%	
Mat (MT)	4.25%	9.48%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Stoku i detyrimeve është reduktuar me më pak se 5% për 24 bashki të tjera dhe për Bashkinë e Patosit nuk ka pësuar ndryshim (0%).

Ndërkohë për nëntë bashki stoku i detyrimeve është rritur me deri 5% dhe për pesë bashki stoku është rritur nga 5%-10%. Statusi i vështirësisë financiare është përqësuar për bashkitë e Lezhës dhe e Roskovecit duke u klasifikuar si bashki në vështirësi financiare në 2020 dhe për bashkinë e Divjakës duke u klasifikuar për herë të parë si një bashki me probleme financiare. (Tabela nr. 4).

TABELA NR. 4 RITJA I STOKUT DERI ME 10% PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, 2019-2020

Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i Ndryshimit
Selenicë (SLN)	18.51%	18.42%	Rritje 0-5%; 9 bashki
Krujë (KRJ)	5.18%	4.94%	
Mallakastër (MLLK)	1.95%	1.36%	
Vau i Dejës (VDJ)	2.32%	1.23%	
Prrenjas (PRRNJ)	3.49%	2.18%	
Përmet (PRM)	4.65%	3.29%	
Kurbin (KRB)	13.58%	11.79%	
Has (HS)	11.56%	9.59%	
Roskovec (RSK)	25.29%	21.53%	
Poliçan (PLC)	47.10%	41.94%	Rritje 5-10%; 5 bashki
Malësi e Madhe (MLM)	8.75%	2.97%	
Himarë (HMR)	10.68%	4.34%	
Divjakë (DVJ)	16.75%	9.88%	
Lezhë (LZH)	26.16%	17.26%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Stoku i detyrimeve financiare është rritur më shumë se 10% për gjashtë bashki. Statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë për pesë bashki, nga bashki pa probleme financiare në bashki me probleme financiare (Delvina) dhe në vështirësi financiare (Kuçovë, Belsh, Këlcyrë). Vecanërisht, Bashkia e Vorës, nga një bashki pa probleme financiare në 2019, klasifikohet si një bashki në vështirësi financiare në 2020 me një stok 75%, shumë pranë statusit të vështirësisë serioze financiare (Tabela nr. 5).


TABELA NR. 5 RITJA I STOKUT MBI 10% PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, 2019-2020

Bashkia	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2019	Niveli i Ndryshimit
Delvinë (DLV)	22.53%	12.26%	Rritje >10%; 6 bashki
Korçë (KRC)	12.87%	2.56%	
Belsh (BLSH)	29.68%	15.25%	
Kuçovë (KCV)	32.32%	13.07%	
Këlcyrë (KLC)	28.84%	1.47%	
Vorë (VR)	74.76%	1.78%	

Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Grafiku nr. 3 pasqyron diferencën 2020-2019 të përqindjes së detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara. 20 bashki e kanë rritur përqindjen e stokut të detyrimeve në 2020, 37 bashki e kanë ulur dhe Bashkia e Patosit nuk ka pësuar ndryshim (0%). Bashkia e Vorës shënon rritjen më të madhe prej 72.98% në 2020 të përqindjes së stokut të detyrimeve të prapambetura nga 2019.

GRAFIKU NR. 3 DIFERENCA 2020-2019 E PËRQINDJES SË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NDAJ SHPENZIMEVE TË MIRATUARA



Burimi: Raportimet e Bashkive 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Tabela nr. 3 pasqyron strukturën e detyrimeve të prapambetura për të gjitha bashkitë me detyrime më të larta se 15% të shpenzimeve të miratuara. Mesatarisht, nga të dhënat e 21 bashkive me probleme apo vështirësi financiare, 25.89% e detyrimeve janë të natyrës së shpenzimeve korrente, 61.73% të natyrës së shpenzimeve kapitale, 11.78% të natyrës nga vendimet gjyqësore dhe 0.82% hua afatgjatë. Në dallim nga viti 2019, vihet re një reduktim i detyrimeve të natyrës së shpenzimeve korrente dhe një rritje të detyrimeve shpenzime kapitale.

Të gjitha bashkitë me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve të miratuara kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale. Bëjnë përjashtim:

1. Bashkia e Kavajës, Tepelenës dhe Finiqit, ku pjesa më e madhe e detyrimeve është e natyrës së shpenzimeve korrente, respektivisht 72.67%, 70.43% dhe 55.32%.
2. Bashkia e Pogradecit, Dibrës dhe e Lezhës, ku pjesa më e madhe e detyrimeve është e natyrës së vendimeve gjyqësore, respektivisht 65.27%, 57.03% dhe 38.09%.

Ndërkohë që Bashkia e Lezhës është e vetmja bashki me detyrime të natyrës së huasë afatgjatë me 9.08% të totalit të detyrimeve të saj.

TABELA NR. 6 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA, DHJETOR 2020

Statusi i Vështirësisë	Bashkia	Detyrime të prapambetura (lekë)	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020 (lekë)	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara 2020	Struktura e Detyrimeve të Prapambetura			
					Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Vendime gjyqësore	Hua
Probleme Financiare	Kamëz (KMZ)	265,387,540	1,652,289,531	16.06%	20.82%	78.42%	0.75%	-
	Divjakë (DVJ)	113,006,060	674,512,000	16.75%	34.32%	63.49%	2.19%	-
	Klos (KLS)	58,368,919	346,983,212	16.82%	15.20%	80.52%	4.28%	-
	Cërrik (CRRK)	75,571,176	431,319,107	17.52%	31.97%	66.15%	1.89%	-
	Selenicë (SLN)	98,988,441	534,915,435	18.51%	20.64%	58.93%	20.42%	-
	Finiq (FNO)	60,362,510	272,709,871	22.13%	55.32%	41.58%	3.10%	-
	Tropojë (TRP)	75,620,737	337,647,000	22.40%	4.73%	86.37%	8.90%	-
	Delvinë (DLV)	51,791,304	229,862,870	22.53%	18.44%	76.98%	4.58%	-
	Kukës (KKS)	173,016,097	748,534,719	23.11%	33.10%	65.13%	1.77%	-
	Dimal (DML)	124,121,418	526,938,670	23.56%	11.71%	76.65%	13.64%	-
	Dibër (DBR)	189,482,772	761,597,687	24.88%	11.21%	31.76%	57.03%	-
Vështirësi Financiare	Roskovec (RSK)	282,705,197	1,117,884,174	25.29%	3.42%	96.42%	0.16%	-
	Lezhë (LZH)	336,912,018	1,288,080,500	26.16%	19.06%	33.77%	38.09%	9.08%
	Tepelenë (TPL)	58,056,725	207,403,000	27.99%	70.43%	19.81%	9.76%	-
	Këlcyrë (KLC)	44,218,688	153,300,000	28.84%	21.18%	78.82%	-	-
	Belsh (BLSH)	97,720,122	329,295,670	29.68%	4.88%	95.11%	0.01%	-
	Pogradec (PGR)	387,090,301	1,232,115,369	31.42%	15.48%	19.25%	65.27%	-
	Kuçovë (KCV)	165,144,481	511,012,291	32.32%	23.14%	76.57%	0.29%	-
	Poliçan (PLC)	102,281,203	217,145,807	47.10%	40.56%	53.09%	6.34%	-
	Kavajë (KVJ)	767,704,732	1,100,850,732	69.74%	72.67%	13.87%	7.78%	5.68%
	Vorë (VR)	702,600,000	939,859,324	74.76%	15.37%	83.56%	1.07%	-
Mesatare					25.89%	61.73%	11.78%	0.82%


Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nëse do të vlerësonim situatën e detyrimeve të prapambetura të bashkive përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit 2020, vihet re një përkeqësim i treguesit të detyrimeve (Grafiku nr. 4). Treguesi i realizimit të buxhetit nga bashkitë për vitin 2020 varion nga 33.17% për Bashkinë e Roskovecit e 33.6% për Bashkinë e Vorës në 99.97% për Bashkinë e Shkodrës. Mesatarisht buxheti realizohet në masën prej 73.53% dhe 28 bashki kanë një tregues të realizimit të buxhetit nën mesatare. Në këto kushte, stoku i detyrimeve të prapambetura përkundrejt buxhetit të realizuar rritet.

Situata në bashkinë e Vorës është shumë më serioze ku detyrimet e prapambetura shënojnë 204% të shpenzimeve faktike në vitin 2020, pasi buxheti për vitin 2020 është realizuar vetëm në masën 36.6%. Po kështu treguesi detyrimeve të prapambetura përkeqësohet për bashkinë e Kavajës me tregues mbi 100% dhe për bashkinë e Roskovecit, Poliçanit me tregues mbi 50%.

Në këto kushte, bashkitë duhet t'i vlerësojnë me kujdes angazhimet e reja financiare në kushtet e ritmeve të ulta të ekzekutimit të buxhetit.


GRAFIKU NR. 4 DETYRIMET E PRAPAMBETURA PËRKUNDREJT SHPENZIMEVE FAKTIKE 2020



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shpenzimet Faktike sipas Raportit Vjetor 2020 mbi Performancën e NJQV

Grafiku nr. 5 pasqyron diferencat mes vitit 2020 e 2019 të përqindjes së detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve të faktike. Vihet re përmirësimi i treguesit të detyrimeve në 2020 për bashkitë e Kolonjës dhe Kamzës me një reduktim prej 74% nga viti 2019 i përqindjes së detyrimeve ndaj shpenzimeve faktike. Ndërkohë një përkeqësim i rëndësishëm vihet re në bashkitë e Vorës dhe Kavajës me një rritje të treguesit në 2020 përkatësisht me 202% dhe 106%. Janë 28 bashki treguesit e detyrimeve 2020-2019 ndaj shpenzimeve faktike të të cilëve pësojnë përkeqësim (të shënuara me të kuqe në grafikun nr. 5).

GRAFIKU NR. 5 DIFERENCA E PËRQINDJES SË DETYRIMEVE PËRKUNDREJT SHPENZIMEVE FAKTIKE MES VITEVE 2020-2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shpenzimet Faktike sipas Raportit Vjetor 2020 mbi Performancën e NJQV

IV. Analiza e Detajuar mbi Treguesit e Detyrimeve të Prapambetura për Secilën Bashki

Bashkia Belsh

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 29.68% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Belshit, më shumë se 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 34.29% (Tabela nr. 8).

TABELA NR. 7 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BELSH, DHJETOR 2020

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Belsh	97,720,122	329,295,670	29.68%	284,988,210	34.29%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 98 milionë lekë me detyrime kryesisht ndaj subjekteve private (Tabela nr. 9). Për sa i përket strukturës së detyrimeve të prapambetura dhjetor 2020, ato për shpenzimet kapitale janë shumë herë më të larta se ato në shpenzimet korrente respektivisht 95.11% dhe 4.88%. Detyrimet për vendimet gjyqësore dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0.01%.

TABELA NR. 8 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BELSH, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	97,720,122		
a	Shpenzime korrente	4,765,138	329,295,670	29.68%
a.1	Mallra dhe shërbime	4,765,138		
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	Shpenzime kapitale	92,941,408		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	92,941,408		
c	Vendime gjyqësore	13,576		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime			
c.4	Të tjera	13,576		
III	Totali (I+II)	97,720,122		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Bashkia Berat

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 12.63% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Beratit, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë pa probleme financiare. Situata është nën mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 17.08% (Tabela nr. 10).

TABELA NR. 9 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, DHJETOR 2020

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Berat	143,347,084	1,134,802,740	12.63%	839,284,297	17.08%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimi deri në dhjetor, detyrimet 143 milionë lekë (Tabela nr. 11). Përsa i përket strukturës së detyrimeve të prapambetura dhjetor 2020, ato për shpenzimet kapitale janë më të larta se ato në shpenzimet korrente respektivisht 57.87% dhe 35.35%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 6.78% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.


TABELA NR. 10 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së		
I	Borxhe (a+b)	0				
a	Hua sftatgjatë	0				
a.1	Principali					
a.2	Interesi					
b	Hua afatshkurtër	0				
b.1	Hua					
b.2	Overdrafte					
b.3	Kredi të furnitorëve					
II	Detyrime (a+b+c)	143,347,084				
a	Shpenzime korrente	50,673,962	1,134,802,740	12.63%		
a.1	Mallra dhe shërbime	5,459,076				
a.2	Paga dhe sigurime					
a.3	Të tjera	45,214,886				
b	Shpenzime kapitale	82,948,474				
b.1	Institucione buxhetore					
b.2	Subjekte private	82,948,474				
c	Vendime gjyqësore	9,724,648				
c.1	Marrëdhënie pune	9,446,779				
c.2	Mallra dhe shërbime					
c.3	Investime					
c.4	Të tjera	277,869				
III	Totali (I+II)	143,347,084				

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në krahasim me vitin 2019, në vitin 2020 kemi një rritje të detyrimeve të natyrës së shpenzimeve kapitale shoqëruar me uljen e detyrimeve të natyrës së shpenzimeve korrente dhe vendimeve gjyqësore (Grafiku nr. 7).

GRAFIKU NR. 6 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BERAT 2020-2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Raporti Vjetor 2019 mbi Statusin e Vështirësisë Financiare të Njqv- Bashki

Sipas raportimeve të Bashkisë lidhur me planin e shlyerjes, Bashkia e Beratit planifikon të shlyjë 69.5% (99,643,110 lekë) të stokut në vitin 2021 dhe pjesa tjetër prej 30.5% (43,703,974 lekë) gjatë vitit 2022.

Bashkia Bulqizë

Detyrimet e prapambetura për periudhën deri në dhjetor 2020 janë 5.14% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Bulqizës, nën 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është nën mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe nën treguesin e totalit të njësisive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 6.08% (Tabela nr. 12).

TABELA NR. 11 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, DHJETOR 2020

Bashkia	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Bulqizë	28,307,781	550,210,000	5.14%	465,295,400	6.08%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimeve, detyrimet janë 28 milionë lekë, ku pjesa më e konsiderueshme janë vendime të formës së vendimeve gjyqësore të natyrës për investime (Tabela nr. 13). Përsa i përket strukturës e detyrimeve të prapambetura deri në dhjetor 2020, ato për shpenzimet kapitale janë më të larta me 76.29% dhe shpenzimet për vendimet gjyqësore janë 23.53%. Detyrimet shpenzime korrente përbëjnë 0.18% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.


TABELA NR. 12 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	28,307,781		
a	Shpenzime korrente	0		
a.1	Mallra dhe shërbime		550,210,000	5.14%
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	Shpenzime kapitale	0		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	28,307,781		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe shërbime	492,251		
c.3	Investime	27,815,530		
c.4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	28,307,781		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në krahasim me vitin 2019, në vitin 2020 detyrimet e prapambetura janë 100% të natyrës së vendimeve gjyqësore në dallim nga 2019 ku detyrimet për vendime gjyqësore ishin rreth 24% dhe 76% ishin detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale (Grafiku nr. 8).

GRAFIKU NR. 7 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË BULQIZË 2020-2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Raporti Vjetor 2019 mbi Statusin e Vështirësisë Financiare të Njqv- Bashki

Sipas raportimeve të Bashkisë lidhur me planin e shlyerjes, Bashkia e Bulqizës planifikon të shlyjë 82.8% (23,452,564 lekë) të stokut në vitin 2021 dhe pjesën tjetër prej 18.2% (4,855,217 lekë) gjatë vitit 2022.

Bashkia Cërrik

Detyrimet e prapambetura deri në 2020 janë 17.52% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Cërrikut, më shumë se 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 23.42% (Tabela nr. 14).

TABELA NR. 13 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË CËRRIK, DHJETOR 2020

Bashkia	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Cërrik	75,571,176	431,319,107	17.52%	322,610,610	23.42%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimeve, detyrimet janë 76 milionë lekë kryesisht ndaj subjekteve private. Përsa i përket strukturës së detyrimeve të prapambetura, ato për shpenzimet kapitale janë më të larta se shpenzimet korrente, respektivisht 66.15% dhe 31.97%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 1.89% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0% (Tabela nr. 15).


TABELA NR. 14 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË CËRRIK, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	75,571,176		
a	Shpenzime korrente	24,158,390	431,319,107	17.52%
a.1	Mallra dhe shërbime	15,321,446		
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera	8,836,944		
b	Shpenzime kapitale	49,986,786		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	49,986,786		
c	Vendime gjyqësore	1,426,000		
c.1	Marrëdhënie pune	1,426,000		
c.2	Mallra dhe shërbime			
c.3	Investime			
c.4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	75,571,176		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në krahasim me vitin 2019, detyrimet e natyrës së shpenzimeve korrente dhe vendimeve gjyqësore janë ulur shoqëruar me rritjen e detyrimeve se natyrës së shpenzimeve kapitale (Grafiku nr. 9).

GRAFIKU NR. 8 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË CËRRIK 2020-2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Raporti Vjetor 2019 mbi Statusin e Vështirësisë Financiare të Njqv- Bashki

Përsa i përket planit të shlyerjes, Bashkia planifikon të shlyejë 50% (37,892,600 lekë) të detyrimeve brenda vitit 2021, 34% (25,610,000 lekë) gjatë vitit 2022 dhe 16% (12,068,576 lekë) gjatë vitit 2022.

Bashkia Delvinë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 22.53% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Delvinës, më shumë se 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 31.87% (Tabela nr. 16).

TABELA NR.15 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË DELVINË, DHJETOR 2020

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Delvinë	51,791,304	229,862,870	22.53%	162,498,389	31.87%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në dhjetor detyrimet janë 52 milionë lekë, kryesisht ndaj subjekteve private. Përsa i përket strukturës së detyrimeve të prapambetura, ato për shpenzimet kapitale janë më të larta se shpenzimet korrente, respektivisht 76.98% dhe 18.44%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 4.58% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0% (Tabela nr. 17).


TABELA NR. 16 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË DELVINË, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	51,791,304		
a	Shpenzime korrente	9,551,106		
a.1	Mallra dhe shërbime	9,551,106	229,862,870	22.53%
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	Shpenzime kapitale	39,867,713		
b.1	Institucione buxhetore	0		
b.2	Subjekte private	39,867,713		
c	Vendime gjyqësore	2,372,485		
c.1	Marrëdhënie pune	283,040		
c.2	Mallra dhe shërbime	2,089,445		
c.3	Investime	0		
c.4	Të tjera	0		
III	Totali (I+II)	51,791,304		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në krahasim me vitin 2019, detyrimet e natyrës së shpenzimeve korrente dhe vendimeve gjyqësore janë ulur shoqëruar me rritjen e detyrimeve se natyrës së shpenzimeve kapitale (Grafiku nr. 10).

GRAFIKU NR. 9 STRUKTURA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË DELVINË 2020-2019



Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Raporti Vjetor 2019 mbi Statusin e Vështirësisë Financiare të Njqv- Bashki

Në lidhje me planin e shlyerjes së detyrimeve, Bashkia planifikon të shlyejë 43% (22,263,768 lekë) të stokut gjatë vitit 2021, 33% (17,263,768 lekë) gjatë vitit 2022 dhe 24% (12,263,768 lekë) gjatë vitit 2023.

Bashkia Devoll

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 9.56% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Devollit, nën 15% duke dëshmuar për një situatë pa probleme financiare. Situata është nën mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe nën treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 13.83% (Tabela nr. 18).

TABELA NR. 17 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË DEVOLL, DHJETOR 2020

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Devoll	57,268,449	599,177,683	9.56%	414,210,113	13.83%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në dhjetor detyrimet janë 57 milionë lekë, kryesisht detyrime të prapambetura për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Në strukturën e detyrimeve të prapambetura, ato për shpenzimet korrente janë më të larta se shpenzimet kapitale, respektivisht 79.28% dhe 12.09%. Detyrimet për vendimet gjyqësore përbëjnë 8.63% dhe detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0%.

TABELA NR. 18 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË DEVOLLIT, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	57,268,449		
a	Shpenzime korrente	45,404,585	599,177,683	9.56%
a.1	Mallra dhe shërbime	44,482,442		
a.2	Paga dhe sigurime	105,109		
a.3	Të tjera	817,034		
b	Shpenzime kapitale	6,922,057		
b.1	Institucione buxhetore	0		
b.2	Subjekte private	6,922,057		
c	Vendime gjyqësore	4,941,807		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe shërbime	4,941,807		
c.3	Investime			
c.4	Të tjera	0		
III	Totali (I+II)	57,268,449		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në lidhje me planin e shlyerjes së detyrimeve, Bashkia planifikon të shlyejë 78% (44,897,991lekë) të stokut gjatë vitit 2021, 12% (6,941,807 lekë) gjatë vitit 2022 dhe 10% (5,428,651 lekë) gjatë vitit 2023.

Bashkia Dibër

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 24.88% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Dibrës, mbi 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njësisve vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 25.92%.

TABELA NR. 19 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË DIBRËS, DHJETOR 2020

	Detyrime të prapambetura	Totali i Shpenzimeve të Planifikuara 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara	Totali i Shpenzimeve Faktike 2020	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike
Bashkia Dibrës	189,482,772	761,597,687	24.88%	731,079,370	25.92%
Totali NJV	6,895,013,355	68,724,667,204	10.03%	51,129,095,589	13.49%
Mesatarja NJV			14.54%		20.94%

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Sipas raportimit deri në dhjetor detyrimet janë 190 milionë lekë, kryesisht detyrime të prapambetura ndaj subjekteve private dhe vendime gjyqësore si shpërblim dëmi dhe nga marrëdhëniet e punës. Përsa i përket strukturës së detyrimeve të prapambetura, ato për vendimet gjyqësore zënë peshën më të madhe me rreth 57% të stokut. Shpenzimet kapitale janë më të larta se shpenzimet korrente, respektivisht 31.76% dhe 11.21%. Detyrimet për hua afatgjata apo afatshkurtra janë 0% (Tabela nr. 21).

TABELA NR. 20 STRUKTURA E DETAJUAR E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË BASHKISË DIBRËS, DHJETOR 2020 (NË LEKË)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVOV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	189,482,772		
a	Shpenzime korrente	21,239,614	761,597,687	24.88%
a.1	Mallra dhe shërbime	20,373,079		
a.2	Paga dhe sigurime	866,535		
a.3	Të tjera			
b	Shpenzime kapitale	60,186,567		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	60,186,567		
c	Vendime gjyqësore	108,056,591		
c.1	Marrëdhënie pune	42,885,800		
c.2	Mallra dhe shërbime	0		
c.3	Shpërblim dëmi	65,170,791		
c.4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	189,482,772		

Burimi: Raportimet e Bashkisë 2020 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në lidhje me planin e shlyerjes së detyrimeve, Bashkia planifikon të shlyejë 60% (112,826,181lekë) të stokut gjatë vitit 2021, ku përfshihen një pjesë e vendimeve gjyqësore dhe të gjitha detyrimet e tjera; 19% (35,000,000 lekë) gjatë vitit 2022 dhe 21% (41,656,591 lekë) gjatë vitit 2023.

Bashkia Dimal

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2020 janë 23.56% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Dimalit, mbi 15% duke dëshmuar për një situatë me probleme financiare. Situata është mbi mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (14.54%) dhe mbi treguesin e totalit të njërive vendore (10.03%). Në përqindje të shpenzimeve faktike 2020, detyrimet e prapambetura janë 33.21% (Tabela nr. 22).

TABELA NR. 21 DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKISË SË DIMALIT, DHJETOR 2020

